



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

Nr. 8474 Prot.

Shkodër, më 06/06/2017

V E N D I M

Nr. 177 datë 06.06.2017.

“Për delegimin e kompetencave”

Në mbështetje të nenit 8, 9 të ligjit nr 139/2015 “ Për vetqeverisjen vendore”, në nenet 28, 29 të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,

U R D H Ë R O J :

- I. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, znj. Emilja Koliqi, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e vogël se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.
- II. Delegimin e kompetencës si nëpunëse e autorizuar, Bashkia Shkoder, zv/kryetarit, znj. Emilja Koliqi, për kryerjen e pagesave për zërat e shpenzimeve paga, sigurime shoqerore, transferta.
- III. Kompetencat e deleguara, do të ushtrohen për periudhën, nga hyrja në fuqi e këtij urdheri deri në datën 31.12.2017.
- IV. Raportimi të kryhet tek nëpunësi Autorizues, me shkrim, çdo muaj pasardhës, për realizimin e detyrave të ngarkuara.
- V. Zv/kryetari, nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen web te Bashkise Shkoder.

